



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 83

Tiranë – E mërkurë, 31 maj 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 17.5.2023	Për përcaktimin e masës së shpërblimit mujor të përhershëm për titull të anëtarëve të Asamblesë së Akademisë së Shkencave..... 9337
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 307, datë 24.5.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës ‘Nezir Muzhaqi’, në zonën kadastrale 8522”, Bashkia Elbasan 9337
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 24.5.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 490, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor <i>By pass</i> , Plepa–Kavajë–Rrogozhinë (loti 7, rrugët dytësore)” 9340
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 309, datë 24.5.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rigjenerimi urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë” 9341
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 316, datë 24.5.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, të ndryshuar.. 9342
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 27.4.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-928 (150), datë 31.5.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 9343
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 9097, datë 25.5.2023	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare..... 9353



VENDIM

Nr. 302, datë 17.5.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
SHPËRBLIMIT MUJOR TË
PËRHERSHËM PËR TITULL TË
ANËTARËVE TË ASAMBLESË SË
AKADEMISË SË SHKENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e Asamblesë së Akademisë së Shkencave përfitojnë një shpërblim mujor të përhershëm, për titullin “Akademik”, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, dhe për titullin “Akademik i asociuar”, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë), edhe nëse marrin statusin e anëtarit “*Emeritus*”.

2. Dhënia e shpërblimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi kryhet nga Akademia e Shkencave dhe përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për këtë institucion.

3. Akademia e Shkencave, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi prej 15 900 000 (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekësh, i cili përballohet nga fondi i kontingjencës, i buxhetit të vitit 2023.

4. Vendimi nr. 399, datë 27.3.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të rregullt, të anëtarëve të përhershëm dhe të anëtarëve të asociuar të Akademisë së Shkencave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 qershor 2023.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM

Nr. 307, datë 24.5.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRUGËS
‘NEZIR MUZHAQI’, NË ZONËN
KADASTRALE 8522”, BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës ‘Nezir Muzhaqi’, në zonën kadastrale 8522”, Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 179 630 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 179 630 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi,



pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, sipas këtij vendimi, për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Elbasan.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri

në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, sipas këtij vendimi, për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Elbasan.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I RRUGËS ‘NEZIR MUZHAQI’ NË ZK 8522”, BASHKIA ELBASAN

Nr.	Pronari			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							Shënime (D+E) (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	ARË			TRUALL			Vlera totale (lek)	
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)		
	A	B	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	Y	Z
1	Lindita Jonaid Hatixhe Aida Gazmend Sokol Irma Adile Zvjetlana Haki Ilirjan	Ibrahim Abdyl Adem Adem Kadri Naim Naim Ali Ali Ali	Myzyri Myzyri Zenelboxha Kacollja Zenelboxha Myzyri Haxhihyseni Çelirama Garunja Kotherja Kotherja	Elbasan	8522	18/24	ARË	13200	13200	0	0			829	222	184,038.00	0	0	0	184,038	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Bashkim	Ymer	Disha	Elbasan	8522	18/254	TRUALL	404.8	0	404.8	95.5	27	193	0	0	0	10.5	12,764	134,022	134,022	Konfirmuar nga ASHK-ja, godinë banimi 1-katëshe, 95.5 m². Kjo kartelë është e vlefshme për shpronësim.
3	Tomorr	Vasil	Dedja	Elbasan	8522	18/273	TRUALL	381	0	381	0	0	0	0	0	0	67,5	12,764	861,570	861,570	Konfirmuar nga ASHK-ja. Kjo kartelë është e vlefshme për shpronësim.
	Vlera totale																			1,179,630	



VENDIM

Nr. 308, datë 24.5.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 490, DATË 22.7.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY PASS,
PLEPA–KAVAJË–RROGOZHINË (LOTI
7, RRUGËT DYTËSORE)’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 490, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3, vlera “...173 753 243 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë...” zëvendësohet me “...173 930 574 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë...”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 173 930 574 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 173 753 243 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë nga buxheti i vitit 2014, zëri “Detyrimet e prapambetura” (detyrimet e infrastrukturës);

b) 177 331 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e një) lekë nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

4. Tabelës bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTT “PËR NJË SHTESË DHE DISA NDRYSHIME NË VKM-në NR. 490, DATË 22.7.2014, PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY PASS PLEPA–KAVAJË–RROGOZHINË (LOTI 7, RRUGËT DYTËSORE)’”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Të dhënat për shpronësim				Adresa
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sip. e shpronësimit (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera totale (lek)	Shënime	
96	MYRIBAN	ABDYL	PERPALI	8552	12/308	arë	420	420	329	138,180.00	Konfirmuar nga ASHK-ja pjesë autostrade	BASHKIA KAVAJË
97	LINDITA	MYSLIM	SHTINI	8552	18/469	arë	140	119	329	39,151.00	Konfirmuar nga ASHK-ja kalon autostrada dhe rruga dytësore	BASHKIA KAVAJË
	ARLIND	ASTRIT	SHTINI									
VLERA TOTALE							560	539		177,331.00		

**VENDIM****Nr. 309, datë 24.5.2023****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIGJENERIMI URBAN I
ZONËS AFËR GJIMNAZIT NË RRUGËN
E DËSHMORËVE, ÇOROVODË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rigjenerimi urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “njësi”, me një vlerë të përgjithshme prej 643 857 (gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 643 857 (gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Skrapar.

8. Bashkia Skrapar kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Skrapar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Skrapar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Skrapar për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Skrapar, pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Skrapar për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Skrapar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Skrapar dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR INTERES PUBLIK, “RIGJENERIMI URBAN I ZONËS AFËR GJIMNAZIT NË RRUGËN E DËSHMOREVE, ÇOROVODË”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)								TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM NDËRTESESË			VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Ndërtesë (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lek)		
1	Batjar	Ibrahim	Laze	Çorovodë	1420	11/51	Njësi	18	18	9	37	18	35,770.00	643,857.00	643,857.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera totale															643,857.00	

VENDIM

Nr. 316, datë 24.5.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 22, DATË 12.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË AGROTURIZMIT DHE NDËRTIMIN E STRUKTURAVE/ OBJEKTEVE NË FUNKSION TË TIJ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në tekstin e vendimit, fjala “... çlodhëse ...” zëvendësohet me “... edukative ...”.

2. Pika 2.2, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.2 Agroturizmi duhet të zotërojë një fermë bujqësore ose blegtorale ose njësi agrikulturore dhe të ofrojë aktivitete argëtuese/edukative, shërbimin e ushqimit e pijes dhe akomodim.”.

3. Shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 4, të kreut II, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Fermë bujqësore, e cila ka të paktën 1 (një) ha tokë në pronësi ose përdorim, të mbjellë me kultura bujqësore;”.

Faqe|9342

“c) Njësi agrikulturore, e cila ka si aktivitet:

i. përpunimin e produkteve bujqësore dhe të paktën 1 (një) ha tokë të mbjellë me kultura bujqësore. Subjekti duhet të ketë edhe një ambient për përpunimin e produkteve bujqësore;

ii. përpunimin e produkteve blegtorale dhe mbarështimin e të paktën 10 (dhjetë) krerëve gjedhë ose 100 (njëqind) krerëve dele ose dhi ose 200 (dyqind) krerëve shpendë. Në këtë rast, subjekti duhet të ketë edhe një ambient për përpunimin e produkteve blegtorale, si p.sh.: qumësht, djathë, kos, dhe për mjeljen e lopëve e deleve;

iii. akuakulturën, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për akuakulturën. Në këtë rast, subjektet duhet të kenë në pronësi ose përdorim sipërfaqe ujore jo më të vogël se 3 000 (tre mijë) m². Subjekti duhet ta përdorë këtë sipërfaqe për kultivimin dhe rritjen e peshkut ose midhjes;

iv. bletërritjen dhe prodhimin e mjaltit, si dhe të ketë të paktën parkun e bletëve, me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje. Në këtë rast, subjekti duhet të ketë në pronësi ose përdorim një ambient për vendosjen e bletëve, si dhe për mbledhjen e prodhimin e nënprodukteve të mjaltit.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4.1 Përjashtimisht, për subjektet që kanë të kategorizuar strukturën akomoduese si “bujtinë”, agroturizmi mund të zhvillohet edhe në:

a) fermë bujqësore, e cila ka të paktën 1 (një) ha tokë në pronësi ose përdorim, të mbjellë me kultura bujqësore;

b) fermë blegtorale, e cila mbarështon, të paktën, 5 (pesë) krerë gjedhë ose 50 (pesëdhjetë) krerë dele ose dhi ose 100 (njëqind) krerë shpendë;



c) njësi agrikulturore, e cila ka si aktivitet bletërritjen dhe prodhimin e mjaltit, me të paktën 30 (tridhjetë) zgjoje bletësh.”.

5. Në pikën 7, togfjalëshi “... 6 deri në 30 dhoma ...”, zëvendësohet me “... nga 6 deri në 60 shtretër ...”.

6. Në pikën 8, pas shkronjës “a” shtohet shkronja a/1, me këtë përmbajtje:

“a/1) në varësi të llojit të strukturës/objektit, kriteret dhe kushtet e përcaktuara në vendimin nr. 711, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese.”.

7. Në pikën 10, togfjalëshi “... 6 deri në 60 tavolina ...” zëvendësohet me “... 10 deri në 80 vende uljeje ...”.

8. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

“19/1. Subjektet e pajisura me “Certifikatë paraprake”, të cilat nuk kanë përfunduar ndërtimin e strukturës brenda afateve të miratuara nga komisioni vlerësues, duhet të paraqesin, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e përfundimit të afatit, dokumentin që vërteton shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit, lëshuar nga autoriteti përgjegjës. “Certifikata paraprake” është e vlefshme për aq kohë sa është shtyrja e afatit të lejes së ndërtimit. Në rast të kundërt, subjekti kthen në buxhetin e shtetit shumën e përfituar, sipas legjislacionit në fuqi, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga afati i përfundimit të “Certifikatës paraprake.”.

9. Pas pikës 21, të kreut IV, shtohet pika 21/1, me këtë përmbajtje:

“21/1. Subjektet e pajisura me “Certifikatë paraprake”, të cilave u ka përfunduar afati i vlefshmërisë së certifikatës, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të paraqesin, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, dokumentin që vërteton shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit, lëshuar nga autoriteti përgjegjës. Në rast të kundërt, subjekti derdh në buxhetin e shtetit shumën e përfituar nga legjislacioni në fuqi, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.”.

II. Kërkesat e paraqitura në ministrinë përgjegjëse për turizmin, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të shqyrtohen sipas kriterëve dhe kushteve të parashikuara në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 24, datë 27.4.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim, i,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 27.4.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (K) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Klaudio Burimi

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-928 (150), datë 31.5.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 4, të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkesut, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme,



që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VEREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë (*Prokuroria e Kavajës*) i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë me kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. 286 të vitit 2016 në ngarkim të kërkuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283, paragrafi 2, i Kodit Penal (KP).

2. Me vendimin nr. 12-2016-1837/162, datë 7.12.2016, pasi ka proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ndër të tjera, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale që akuzohej dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim, ku pasi ka zbritur 1/3-n e dënimit, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), e ka dënuar përfundimisht me 4 vjet e 8 muaj burgim. Në këtë rast, gjykata ka urdhëruar fillimin e vuajtjes së dënimit nga dita e ekzekutimit të masës së sigurimit “Arrest në burg”, data 31.3.2016.

3. Mbi ankimin e të pandehurve, përfshirë edhe të kërkuesit, me vendimin nr. 404/10-2017-1293, datë 25.5.2017, Gjykata e Apelit Durrës ka ndryshuar pjesërisht vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe, ndër të tjera, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale që akuzohej, por të mbetur në tentativë, duke i caktuar përfundimisht të njëjtën masë dënimi (4 vjet e 8 muaj burgim), për pjesën e pavuajtur të të cilit, në zbatim të nenit 59 të KP-së, ka urdhëruar që ai të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës prej 3 vjetësh të mos kryejë veprë tjetër penale. Në këtë rast, në zbatim të nenit 60 të KP-së, si detyrim për kërkuesin e dënuar të vënë në provë, gjykata ka përcaktuar atë të moshoqërimin me persona me precedentë penalë.

4. Në kushtet kur dënimi i caktuar ndaj kërkuesit është pezulluar me kusht, masa e sigurimit “Arrest në burg” është shuar *ipso lege* sipas nenit 261, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, ndërsa

ai është liruar menjëherë nga paraburgimi. Ndërkohë, duke qenë para një “vendimi gjyqësor të formës së prerë të ekzekutueshëm”, sipas interpretimit të bërë me vendimin unifikues nr. 2/2014, të Gjykatës së Lartë, në zbatim të neneve 462, pika 1 dhe 463 të KPP-së së kohës, me urdhrin nr. 143, datë 27.6.2017, Prokuroria e Kavajës ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit nr. 12-2016-1837/162, datë 7.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, të ndryshuar me vendimin nr. 404/10-2017-1293, datë 25.5.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës në lidhje me ekzekutimin nga kërkuesi të pjesës së pavuajtur të dënimit me burgim, pikërisht të dënimit alternativ. Kërkuesi është urdhëruar që gjatë kohës së provës deri më 25.5.2020, të vendosë menjëherë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Kavajë (*Shërbimi i Provës*) dhe të mos kryejë veprë tjetër penale, ndërkohë që Shërbimi i Provës është urdhëruar për të mbikëqyrur kërkuesin deri në përfundim të kohës së provës.

5. Nga ana tjetër, mbështetur në nenin 408 të KPP-së, prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka ushtruar rekurs kundër vendimit të kësaj të fundit për sa u përket disponimeve në lidhje me kërkuesin, i cili, nga ana tjetër ka paraqitur kundërrkurs. Sipas të dhënave nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se çështja është regjistruar në këtë gjykatë në datën 7.9.2017.

6. Ndërsa çështja vijonte të ishte në pritje për t’u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë, periudha e mbikëqyrjes (koha e provës) së kërkuesit ka përfunduar. Me shkresën nr. 512/4 prot., datë 28.5.2020, në zbatim të nenit 31/11, të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar (*ligji nr. 8331/1998*), Shërbimi i Provës i ka dërguar Prokurorisë së Kavajës raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Sipas këtij raporti, kërkuesi i dënuar i vënë në provë për një periudhë 3-vjeçare ka përmbushur rregullisht detyrimet e caktuara ndaj tij, duke përfunduar masën e dënimit alternativ të dhënë nga gjykata. Mbështetur në këtë raport, Prokuroria e Kavajës ka nxjerrë vendimin e datës 4.6.2020, për kryerjen e dënimit alternativ, me të cilin ka vendosur pushimin e ekzekutimit sipas urdhrit të saj nr. 143, datë 27.6.2017, për shkak të përmbushjes rregullisht nga kërkuesi të detyrimeve në zbatim të



vendimit të gjykatës, duke plotësuar në këtë mënyrë dënimin me kusht.

7. Për rekursin e prokurorisë, me vendimin nr. 00-2022-928 (150), datë 31.5.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 404/10-2017-1293, datë 25.5.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 12-2016-1837/162, datë 7.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si dhe njoftimin e Prokurorisë së Përgjithshme për vënien në ekzekutim të këtij vendimi.

8. Në datën 12.8.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, duke pretenduar se vendimi nr. 00-2022-928 (150), datë 31.5.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejta kushtetuese.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në aspekt të:

9.1. *Parimit ne bis in idem*, të parashikuar nga neni 34 i Kushtetutës dhe neni 4, i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, përmes të cilit është rikthyer në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimit Penal (*IEVP*), është dhënë pas rreth 5 vjetësh nga fillimi i ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë dhe 2 vjetësh pas shlyerjes së plotë të dënimin alternativ të caktuar nga Gjykata e Apelit Durrës. Përmes vendimmarrjes së saj, *de facto*, Gjykata e Lartë i ka ngarkuar një dënim të dytë. Rikthimi në burg, duke mos marrë në konsideratë periudhën 3-vjeçare në Shërbimin e Provës dhe sjelljen korrekte të tij ka humbur qëllimin ndëshkues dhe rehabilitues të dënimin.

9.2. *Parimit të sigurisë juridike*, si rrjedhojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë që e ka rikthyer në burg. Kolegji Penal i kësaj gjykate nuk ka marrë parasysh kryerjen prej tij të shërbimit të provës dhe kohën e gjatë prej 4 vjetësh në pritje të shqyrtimit të rekursit, pas regjistrimit të tij në atë gjykatë.

9.3. *Standardit të gjykimin brenda një afati të arsyeshëm*, si rrjedhojë e gjykimin të rekursit nga Gjykata e Lartë tej afatit të arsyeshëm.

10. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, ka parapësuar se:

10.1. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit *ne bis in idem* është i pabazuar. Në kuptim të nenit 34 të Kushtetutës dhe nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, ky parim është i lidhur me pasjen e një vendimi përfundimtar, të formës së prerë, në formën e gjësë së gjykuar, çka është pranuar edhe nga legjislacioni procedural penal, teoria e praktika gjyqësore dhe vendimi unifikues nr. 2, datë 3.11.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas këtyre akteve, vendimi i gjykatës së apelit është i ekzekutueshëm, por jo përfundimtar. Edhe pse pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte për ndikimin e vendimmarrjes së saj në realizimin e suksesshëm të dënimin alternativ është i pranueshëm, mungesa e tij nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor, për aq kohë sa kjo problematikë i takon fazës së ekzekutimit të vendimeve penale. Problemi në rastin konkret qëndron në mosekzistencën e rregullimeve të qarta ligjore në lidhje me alternativat e dënimin me burgim dhe shërbimin e provës, në drejtëm të situatës së korrelacionit mes kufizimeve të përjetuara nga individit dhe dënimin përfundimtar të mundshëm me burgim.

10.2. Ndonëse vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka përkeqësuar gjendjen e vendosur me një vendim të mëparshëm të gjykatës së apelit, pretendimi i kërkuesit për *cenimin e parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Kjo mundësi e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë është parashikuar qartë në legjislacionin procedural dhe individit nuk mund të pretendojë se nuk ka pritshmëri që kjo gjykatë të prishë vendimin e gjykatës së apelit.

10.3. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *standardit të gjykimin brenda një afati të arsyeshëm* është i pabazuar. Vonesat në gjykim kanë ardhur si pasojë e pamundësisë objektive për procedim, të shkaktuar nga mospasja përkohësisht e kapaciteteve njerëzore të nevojshme për përballimin, brenda afateve të arsyeshme, të stokut të çështjeve të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134,



pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraparak të kërkesës.

12. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuksi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës kërkon që individ i t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimin nr. 12, datë 24.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 13, datë 10.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata konstaton se pretendimi për cenimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë është parashtruar nga kërkuksi drejtpërdrejt përpara saj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh, pas hyrjes në fuqi të instrumentit mbi konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, sipas neneve 399/1–399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duhet

të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), ndaj për këtë pretendim Gjykata vëren se kërkuksi nuk ka shteruar mjetet në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për sa u përket pretendimeve të tjera, në ankimin kushtetues individual kërkuksi ka kundërshtuar vendimin nr. 00-2022-928 (150), datë 31.5.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor penal në ngarkim të tij, për rrjedhojë, në lidhje me to, Gjykata vlerëson se kërkuksi i ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë shkelur.

15. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 31.5.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.8.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuksi ka pretenduar cenimin e parimit *ne bis in idem* dhe të parimit të sigurisë juridike. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të kërkuksit ka të bëjë me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili, sipas tij, është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, pasi ka vendosur rikthimin e tij në burg pas 2 vjetësh nga shlyerja e plotë e dënimit alternativ të caktuar nga Gjykata e Apelit Durrës, duke i cenuar lirinë personale. Nisur nga rëndësia e veçantë që merr kjo liri themelore e individit, Gjykata do t'i analizojë pretendimet e kërkuksit në këndvështrim të kësaj të drejte në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit

17. Kërkuksi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë për rikthimin e tij në IEVP është dhënë pas rreth 5 vjetësh nga fillimi i ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë dhe 2 vjetësh nga shlyerja e plotë e dënimit alternativ të caktuar nga Gjykata e Apelit Durrës. Përmes vendimmarjes së saj, *de facto*, Gjykata e Lartë i ka ngarkuar një dënim të dytë. Rikthimi në burg i kërkuksit, duke mos marrë në konsideratë periudhën 3-vjeçare në



shërbimin e provës dhe sjelljen korrekte të tij, ka humbur qëllimin ndëshkues dhe rehabilitues të dënimit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh kryerjen prej kërkuesit të shërbimit të provës dhe kohën e gjatë prej 5 vjetësh në pritje të shqyrtimit të rekursit, pas regjistrimit të tij në atë gjykatë.

18. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ndonëse vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka përkeqësuar gjendjen e vendosur me një vendim të mëparshëm të gjykatës së apelit, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Kjo mundësi e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë është parashikuar qartë në legjislacionin procedural dhe individit nuk mund të pretendojë se nuk ka pritshmëri që kjo gjykatë të prishë vendimin e gjykatës së apelit. Problemi, në rastin konkret, qëndron në mosekzistencën e rregullimeve të qarta ligjore në lidhje me alternativat e dënimit me burgim dhe shërbimin e provës, në drejtim të situatës së korrelacionit mes kufizimeve të përjetuara nga individit dhe dënimit përfundimtar të mundshëm me burgim.

19. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ajo mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në pikën 2 të tij, ku, ndër të tjera, përfshihet dënimi i individit me burgim nga gjykata kompetente (*shkronja "a"*).

20. Gjykata ka theksuar se qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një "shoqëri demokratike". Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë, është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit të brendshëm dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të përmbushë standardin e "*ligjshmërisë*" të përcaktuar nga Konventa, një standard i cili kërkon që ligji të jetë mjaftueshëm i qartë për t'i mundësuar individit që të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme rrethanat, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (*shih vendimin nr. 39, datë 15.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i cilësdo natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të

dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata ka theksuar se që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer (*shih vendimet nr. 47, datë 26.7.2012; nr. 19, datë 1.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, në caktimin e dënimit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese. Në këtë mënyrë, gjykata, gjatë dhënies së dënimit, vlerëson se cili lloj dënimi është në përpjesëtim me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit të saj (*shih vendimin nr. 19, datë 1.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata thekson rëndësinë e funksionit riedukativ të dënimit penal në përmbushjen e qëllimit për të cilin ai jepet. Kështu, krahas përmbushjes së qëllimit ndëshkues për veprën penale të kryer, shlyerja e dënimit penal nënkupton edhe përmbushjen e funksionit riedukues të tij, përmes realizimit të efektit parandalues për kryerjen e veprave të tjera penale, si dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri, aspekte këto të rëndësishme të drejtësisë penale.

23. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se me rikthimin e tij në IEVP, dënimi ka humbur qëllimin e tij ndëshkues dhe rehabilitues, për shkak të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, përmes së cilës është vendosur prishja e vendimit nr. 404/10-2017-1293, datë 25.5.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 12-2016-1837/162, datë 7.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si dhe njoftimi i Prokurorisë së Përgjithshme për ekzekutimin e vendimit.

24. Në lidhje me këtë vendimarrje, Gjykata konstaton se bazuar në dispozitat e KPP-së që rregullojnë procedurat e gjykimit të shkurtuar, gjykata e rrethit e ka deklaruar kërkuesin fajtor për veprën penale të kryer, duke e dënuar përfundimisht me 4 vjet e 8 muaj burgim. Vendimi i saj është pranuar nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila e ka dënuar kërkuesin po me 4 vjet e 8 muaj burgim, por e ka ndryshuar atë për sa i përket ekzekutimit të dënimit me burgim, duke vendosur



pezullimin për 3 vjet të periudhës së mbetur, si dhe urdhërimin e kërkuarit të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës e të mos shoqërohet me persona me precedentë penalë. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Apelit Durrës është vënë në ekzekutim nga Prokuroria e Kavajës, e cila ka urdhëruar Shërbimin e Provës, Kavajë të mbikëqyrë kërkuarin deri në datën 25.5.2020, kur përfundonte afati 3-vjeçar i përcaktuar në vendimin e gjykatës së apelit për vënien e tij në provë. Me përfundimin nga kërkuari të dënimit me kusht, Prokuroria e Kavajës ka vendosur pushimin e ekzekutimit të urdhrit të saj për mbikëqyrjen e kërkuarit, si dhe ka urdhëruar arkivimin e dosjes. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka ushtruar rekurs prokuroria pranë kësaj gjykate, ndërsa kërkuari ka ushtruar kundërrkurs. Me vendimin nr. 00-2022-928 (150), datë 31.5.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit dhe njoftimin e Prokurorisë së Përgjithshme për vënien në ekzekutim të këtij vendimi.

25. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave për çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuari ka pasur një dënim penal 4 vjet e 8 muaj burgim për veprën penale për të cilën është akuzuar, vuajtja e të cilit ka filluar nga data 31.3.2016. Ky dënim është shlyer prej tij pjesërisht në paraburgim, që, i llogaritur sipas nenit 57 të KP-së, është i barabartë me gati 22 muaj burgim, ndërsa pjesa e mbetur, rreth 34 muajsh, është shlyer përmes kryerjes së shërbimit të provës përgjatë 3 vjetëve. Përpara vlerësimit të këtij fakti në rastin e kërkuarit, Gjykata çmon të ndalet në evidentimin e legjislacionit penal në lidhje me rastet e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë, detyrimet e tij gjatë periudhës së provës, si dhe pasojat e shkeljes së kushteve të këtij dënimi alternativ.

26. Kështu, Gjykata vëren se zbatimi nga gjykatat i nenit 59 të KP-së kërkon përmbytjen e një sërë kushtesh dhe kriteresh ligjore, të tilla si: rrezikshmëria e pakët e personit, mosha, kushtet shëndetësore ose mendore, mënyra e jetesës dhe nevojat, veçanërisht ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe sjellja pas kryerjes së veprës penale. Krahas tyre, vënia në provë kërkon një maksimum dënimi deri në 5 vjet burg për veprën penale të

kryer; moskryerjen gjatë kohës së provës të veprave të tjera penale nga i dënuari; përmbytjen prej tij të një ose më shumë detyrimeve, një ndër të cilat është edhe mosshoqërimi me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar ose bashkëpunëtorë të veprës penale (*neni 60, pika 9, i KP-së*).

27. Në lidhje me detyrimet e të dënuarit, KP-ja ka parashikuar se gjatë periudhës së provës ai duhet të paraqitet rregullisht e të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës (*neni 61, shërkronja "a", i KP-së*), organ ky i ngarkuar nga ligji nr. 8331/1998 me mbikëqyrjen, gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ të përmbytjes së detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, këshillimin e të dënuarit në përmbytjen e tyre, dhënien e ndihmës në integrimin e tij social, si dhe të cilit i është njohur e drejta për t'i propozuar prokurorit ndryshimin e kushteve dhe detyrimeve të caktuara ndaj të dënuarit, caktimin e detyrimeve shtesë ose zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, kur verifikon faktet dhe rrethanat e mospërmbytjes së tyre nga i dënuari (*neni 62, paragrafi 2, i KP-së dhe nenet 31/7 dhe 31/9, të ligjit nr. 8331/1998*). Në rast të mosmbajtjes së kontakteve me Shërbimin e Provës ose mospërmbytjes së detyrimeve, gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit (*neni 59, pika 5, i KP-së*).

28. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata pranon se, ashtu siç pretendohet edhe nga Prokuroria e Përgjithshme, legjislacioni procedural penal, konkretisht neni 441, pika 1, shkronja "b", i KPP-së, parashikon qartësisht prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë si mënyrë disponimi të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin e kërkuarit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur në përputhje me kompetencën e tij, duke përzgjedhur një prej alternativave vendimmarrëse të parashikuara në nenin 441 të KPP-së, sipas gjetjeve dhe përfundimeve të arritura prej tij pas vlerësimit të shkaqeve ligjore të parashtruara në rekurs dhe analizës së vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta. Për këtë arsye, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, nuk qëndron.

29. Megjithatë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret vlerë përcaktuese në pasojat që



vendimarrja e Gjykatës së Lartë ka sjellë ndaj kërkuesit ka luajtur situata faktike e mbivendosjes së kohës së shqyrtimit të rekursit të prokurorisë me atë të përfundimit nga kërkuesi të ekzekutimit të dënimit alternativ të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe kryerjes së plotë prej tij të këtij dënimi, sipas urdhërimit të gjykatës, situatë e cila kërkon vlerësim të veçantë kushtetues në drejtim të kufizimit të lirisë personale, si rrjedhojë e përputhshmërisë së kohës së ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit me përfundimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë.

30. Në analizë të situatës faktike dhe juridike të kërkuesit, Gjykata konstaton se bëhet fjalë për një proces të vetëm gjyqësor, në kuadër të të cilit, për një fakt të caktuar penal, kërkuesi është dënuar me burgim nga gjykata e shkallës së parë. Ai ka vijuar të qëndrojë në paraburgim deri kur gjykata e apelit, mbi ankimin e kërkuesit, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe e ka vënë atë në provë. Alternativa e dënimit me burgim e urdhëruar nga gjykata e apelit nuk është një dënim i ri, pasi dënimi ka vijuar të jetë ai me burgim, por përmes dënimit alternativ kërkuesi është përjashtuar nga ekzekutimi i menjëhershëm i këtij dënimi, duke u zëvendësuar me vënien në provë të tij. Me përmbushjen e detyrimeve të caktuara gjatë kohës së provës, vendimi i dënimit alternativ është ekzekutuar sipas ligjit dhe prokurori ka nxjerrë vendim të veçantë për kryerjen e tij. Në këtë mënyrë, kërkuesi ka vuajtur tërësisht dënimin e caktuar ndaj tij. Ndërkohë, paralelisht me ekzekutimin e vendimit të dënimit alternativ, ka vijuar edhe gjykimi i çështjes ndaj kërkuesit, ku pas ekzekutimit të vendimit të dënimit alternativ, mbi bazën e rekursit të prokurorit, gati pas 5 vjetësh nga dhënia dhe 2 vjetësh nga vuajtja e tij, ky vendim është prishur nga Gjykata e Lartë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka urdhëruar zbatimin e tij, çka nënkupton vuajtjen nga kërkuesi të një pjese të dënimit me burgim tashmë fizikisht duke iu hequr liria.

31. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk del që kjo gjykatë të ketë vlerësuar situatën konkrete të kërkuesit në drejtim të zbatimit prej tij të vendimit dhe urdhërimeve të Gjykatës së Apelit Durrës ose fazën e ekzekutimit nga ai të dënimit alternativ. Po kështu, në këtë vendim, fakti i vuajtjes së dënimit alternativ nga kërkuesi nuk gjen pasqyrim në

përmbajtjen e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Në kushtet e mbivendosjes së fazës së gjykimit me atë të ekzekutimit, fakti i vuajtjes së dënimit nga kërkuesi ka qenë relevant për kontrollin rishikues të Gjykatës së Lartë, për sa kohë objekt i tij ka qenë edhe dënimi alternativ i dhënë nga gjykata e apelit, duke mos qenë e tillë masa e dënimit e caktuar ndaj tij. Në këtë pikëpamje, ndërsa ekzekutimi i dënimit për shkak të kohës së kaluar potencialisht duhet të kishte përfunduar, çka passillte implikime për vendimin që asaj i është kërkuar të jepte, Gjykata e Lartë ka pasur detyrimin për marrjen e informacionit në këtë drejtim, për të shmangur në këtë mënyrë rindëshkimin e kërkuesit pas shlyerjes më parë të dënimit.

32. Gjykata vlerëson se nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Lartë kërkuesi është ngarkuar të vuajë sërish një pjesë të dënimit me burgim të vuajtur më parë prej tij në një prej mënyrave alternative të këtij dënimi. Sipas Gjykatës, një vendimarrje e tillë, e ndërlidhur me një arsyetim të mangët të situatës faktike dhe juridike të kërkuesit, duke mos vënë në diskutim dhe mos marrë në analizë faktin se dënimi me burgim i caktuar ishte ekzekutuar tërësisht, ka cenuar lirinë personale të kërkuesit, si dhe funksionin e dhënies së drejtësisë penale dhe atë riedukativ të dënimit, në kushtet kur kërkuesi tashmë e kishte kryer dënimin penal për veprën e kryer.

33. Nën dritën e analizës së mësipërme, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, tashmë Gjykata ka qëndrim të konsoliduar se, në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ripohon rolin e Gjykatës së Lartë, e cila si gjykatë e ligjit i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të ushtruar rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 28, datë 30.3.2017; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit është i bazuar.



34. Në përfundim, Gjykata çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuarit, sipas arsytimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2022-928 (150), datë 31.5.2022, të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.4.2023.

Shpallur më 29.5.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim

Anëtar kundër: Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Klaudio Burimi, me objekt “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-928 (150), datë 31.5.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, unë, gjyqtarja Marsida Xhaferllari, jam kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësoj se kërkesa duhet të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, po parashtoj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuari është proceduar penalisht nën masën e sigurimit “Arrest në burg” prej datës 31.3.2016. Gjykata e shkallës së parë në datën 7.12.2016 e ka deklaruar fajtor atë për veprën penale të shitjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283, paragrafi 2, i KP-së dhe e ka dënuar përfundimisht me 4 vjet e 8 muaj burgim. Gjykata e apelit në datën 25.5.2017 ka vendosur lënien në fuqi të masës së dënimit, por ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim sipas nenit 59 të KP-së, lirin e kërkuarit dhe vënien e tij në provë për 3 vjet, me arsyetimin se vepra penale kishte mbetur në tentativë. Prokuroria, duke mos qenë dakord me cilësimin juridik të veprës penale në tentativë dhe as me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, ka ushtruar rekurs, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 7.9.2017.

3. Ndërkohë, në datën 27.6.2017 prokurori ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal. Me kalimin e 3 vjetëve të provës, ndonëse çështja ishte në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, prokurori, me urdhrin e datës 28.5.2020, ka vendosur pushimin e ekzekutimit, me arsyetimin se dënimi penal “masë alternative” ishte kryer nga kërkuari.

4. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin e prokurorit pas rreth 5 vjetësh dhe me vendimin e datës 31.5.2022 ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, me pretendimin se i ka cenuar të drejtat kushtetuese për të mos u dënuar dy herë për të njëjtën veprë penale (*ne bis in idem*) dhe për proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të sigurisë juridike dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të garantuara respektivisht nga nenet 34 dhe 42 të Kushtetutës.

6. Mbi këto fakte dhe pretendime, shumica ka vendosur pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar se kërkuari i është cenuar liria personale në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit (*shih paragrafin 33 të vendimit*). Shumica ka arritur në këtë konkluzion, duke vlerësuar se: (i) kërkuari nuk legjitimohet për pretendimin për cenimin e së drejtës së gjykimit të çështjes brenda afatit të



arsyeshëm, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion (*shih paragrafin 14 të vendimit*); (ii) dhe kërkuesi nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Lartë është ngarkuar të vuajë sërish një pjesë të dënimit me burgim të vuajtur më parë prej tij në një prej mënyrave alternative të këtij dënimi, gjë e cila, e ndërlidhur me një arsyetim të mangët të situatës faktike dhe juridike të tij, i ka sjellë atij cenimin e lirisë personale dhe funksionin e dhënies së drejtësisë penale, dhe atë riedukativ të dënimit, në kushtet kur kërkuesi tashmë e kishte kryer dënimin penal për veprën e kryer (*shih paragrafin 32 të vendimit*).

7. Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës, pasi vlerësoj se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara dhe se liria personale e tij është kufizuar në përputhje me kriteret e përcaktuara nga neni 27 i Kushtetutës. Ky konkluzion bazohet në pesë arsytet e mëposhtme.

8. *Së pari*, çështja e kërkuesit me objekt shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë bazohet në tre shkaqe kushtetuese, të formuluar prej tij si pretendime: (i) dënimi dy herë për të njëjtën veprë penale (*ne bis in idem*), që ndalohet nga neni 34 i Kushtetutës, në kushtet kur atij iu caktua dënim me burgim nga Gjykata e Lartë, pasi kishte përfunduar alternativën e dënimit me burgim; (ii) shkella e pritshmërive të ligjshme të kërkuesit në kushtet kur atij iu ndryshua lloji dhe masa e dënimit penal, pasi prokurori kishte vendosur pushimin e ekzekutimit pas përfundimit të masës alternative; (iii) dhe gjykimi i zgjatur në kohë i rekursit të prokurorit nga Gjykata e Lartë, që ndikoi në mënyrë vendimtare në dy shkaqet e mësipërme.

9. Neni 34 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale dhe as të gjykohe sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një veprë penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Ideja e këtij parimi nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën veprë penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri “e njëjta veprë” i

referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor të tyre, që formojnë bazën e kësaj veprë dhe për të cilën personi është dënuar ose liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 33, datë 22.7.2011; nr. 10, datë 2.4.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për sa më lart, pretendimi për cenimin e parimit *ne bis in idem* është i pabazuar, pasi ai gjen zbatim në procedura penale paralele, që nuk është rasti i kërkuesit. Ndaj tij është zhvilluar një procedim i vetëm gjyqësor penal, objekti i të cilit ka qenë verifikimi i fajësisë dhe dënimi penal i kërkuesit për veprën penale të shitjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim. Vendimet gjyqësore të dhëna ndaj kërkuesit deri në gjykatën e apelit nuk mund të konsiderohen përfundimtare për efekt të zbatimit të parimit *ne bis in idem*, pasi nuk kanë përmbyllur në themel procedimin penal, përkundrazi, ky i fundit ishte në proces dhe u përfundua me vendimin e Gjykatës së Lartë¹. Kjo e fundit, duke shqyrtuar dhe vendosur për rekursin e prokurorit, ka ushtruar funksionin e saj kushtetues sipas nenit 141 të Kushtetutës, sepse u ka dhënë kuptim koncepteve ligjore të KP-së lidhur me tentativën, veprën penale të kryer dhe kushteve që duhet të ekzistojnë për caktimin e alternativës së dënimit me burgim.

11. Lidhur me parimin e sigurisë juridike, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 11, datë 21.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

¹ Shih vendimin unifikues penal nr. 2/2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.



12. Në çështjen konkrete nuk mund të pranohet se kërkuksi kishte pritshmëri të ligjshme që dënimi penal i tij të mos ndryshonte për shkak se ai kishte përfunduar alternativën e dënimit me burgim, që i ishte caktuar nga gjykata e apelit. Kërkuksi ishte në dijeni se ndaj vendimit të gjykatës së apelit prokurori kishte paraqitur rekurs për çështje të zbatimit të ligjit, që lidheshin pikërisht me cilësimin juridik të saktë të veprës penale “në tentativë ose të kryer”, si dhe kuptimin e kushteve ligjore të nenit 59 të KP-së, që ishte argumenti kryesor i gjykatës së apelit për caktimin e alternativës së dënimit me burgim. Kuptimi i koncepteve ligjore dhe zbatimi i tyre në çështje konkrete është në kompetencë të Gjykatës së Lartë, ndaj pritshmëritë e kërkuksit qartësisht nuk gjejnë ndonjë mbrojtje nga ligji. Për rrjedhojë, edhe pretendimi i kërkuksit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në aspektin e pritshmërive të ligjshme, është i pabazuar.

13. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, ndaj të njëjtin vlerësim me shumicën për moslegjitimitimin e kërkuksit sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion. Megjithatë, në shtesë të arsytimit të shumicës, duhet evidentuar se kohëzgjatja prej rreth 5 vjetësh e shqyrtimit të rekursit prej Gjykatës së Lartë është paraqitur nga kërkuksi si argument me rëndësi përcaktuese në pritshmëritë e ligjshme të tij për parimet *ne bis in idem* dhe të sigurisë juridike. Në këtë pikëpamje, zgjedhja që ka bërë kërkuksi për të mos përdorur mjetet që ka pasur në dispozicion është një prej faktorëve që ka ndikuar në situatën e tij, përtej kohës që iu desh Gjykatës së Lartë të vendoste për çështjen e tij.

14. Së dyti, shumica me vendimin e saj jo vetëm që nuk i dha përgjigje pretendimeve të kërkuksit, por tejkaloi shkaqet e parashtruara në kërkesë, duke vlerësuar me nismën e saj t’i trajtonte pretendimet në një perspektivë të pakërkuar prej tij, si pretendime për cenimin e lirisë personale të lidhur me arsytimin e vendimit gjyqësor. Në këtë pikë, duhet evidentuar se neni 48 i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, ndërsa vetë Gjykata ka pohuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë

thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 22, datë 11.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Së treti, ndaj mendim të ndryshëm me shumicën edhe për themelin e çështjes së lirisë personale të lidhur me arsytimin e vendimit. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se liria e personit mund të hiqet në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se një prej këtyre rasteve është ai i dënimit me burgim nga gjykata kompetente (*pika 2*). Në rastin e kërkuksit, vlerësoj se Gjykata e Lartë, në cilësinë e gjykatës kompetente për shqyrtimin e rekursit të prokurorit, për çështje të zbatimit të ligjit penal, ka dhënë vendim penal dënimi me burgim ndaj kërkuksit për vepër penale të parashikuar nga KP-ja dhe sipas procedurave të parashikuara nga KPP-ja, ndaj liria personale e kërkuksit është kufizuar në përputhje me kriteret kushtetuese.

16. Së katërti, në rastin e kërkuksit ka një anomali në dukje në procesin penal, në përfundim të të cilit është vendosur që ai të vuajë dënim me burgim, ndonëse prokurori më herët kishte deklaruar të ekzekutuar alternativën e dënimit me burgim të caktuar nga një gjykatë më e ulët. Kjo anomali në dukje i atribuohet kohëzgjatjes prej rreth 5 vjetësh të shqyrtimit të rekursit prej Gjykatës së Lartë, si dhe vënies në ekzekutim të vendimit penal nga prokurori, megjithëse procesi penal, për shkak të rekursit të prokurorit, nuk ishte bërë ende përfundimtar. Megjithatë, kjo anomali e funksionimit të strukturave të sistemit të drejtësisë nuk e bën antikushtetues vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili është dhënë brenda kufijve të kompetencës së saj dhe sipas procedurave të rregullta ligjore. E thënë ndryshe, shqyrtimi dhe riparimi i saj nuk duhet të ishte objekt i këtij gjykimi kushtetues, pasi sistemi ynë ligjor i ka vënë individit mjete efektive në dispozicion, ndër të cilat përfshihen kërkesat për përsheptimin e procedurave gjyqësore, sipas neneve 399/1 e vijuese të KPC-së, si dhe kërkesat në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, sipas neneve 470 e vijuese të KPP-së. Nëse çështja do të shihej nën këtë optikë, atëherë Gjykata do të duhej të kishte konkluduar se kërkuksi nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive që ka në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës.

17. Nën këtë analizë, nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës se “në kushtet e mbivendosjes së fazës së gjykimit me atë të ekzekutimit, fakti i vuajtjes së



dënimit nga kërkuesi ka qenë relevant për kontrollin rishikues të Gjykatës së Lartë, për sa kohë objekt i tij ka qenë edhe dënimi alternativ i dhënë nga gjykata e apelit, duke mos qenë e tillë masa e dënimit e caktuar ndaj tij. Në këtë pikepamje, ndërsa ekzekutimi i dënimit për shkak të kohës së kaluar potencialisht duhet të kishte përfunduar, çka passillte implikime për vendimin që asaj i është kërkuar të jepte, Gjykata e Lartë ka pasur detyrimin për marrjen e informacionit në këtë drejtim, për të shmangur në këtë mënyrë rindëshkimin e kërkuesit pas shlyerjes më parë të dënimit” (shih paragrafin 31 të vendimit).

18. Ky qëndrim i shumicës vendos një barrë joproporcionale ndaj Gjykatës së Lartë kur ajo shqyrton rekurse për fazën e gjykimit, si dhe passjell efekte të paqarta në praktikën e punës së saj, që e tejkalojnë çështjen e kërkuesit. Më duhet të theksoj se objekt i shqyrtimit të Gjykatës së Lartë ka qenë rekursi i prokurorit mbi cilësimin juridik të veprës penale “në tentativë ose e kryer” dhe kushtet ligjore të caktimit të masës alternative sipas nenit 59 të KP-së, pra nëse këto kushte ligjore ekzistonin në kohën që gjykata e apelit dha vendimin për masën alternative, të cilat janë arsyetuar prej saj plotësisht (shih paragrafët 21–23 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Me fjalë të tjera, objekt i shqyrtimit të Gjykatës së Lartë nuk ka qenë se si dhe sa ishte ekzekutuar dënimi penal ndaj kërkuesit, çështje që sipas ligjit i përkasin fazës së ekzekutimit të procedimit penal.

19. Së pesti, nën frymën e parimeve të shtetit të së drejtës dhe të ndarjes së pushteteve, të garantuara nga nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, jam kundër qëndrimit të shumicës, edhe pse parimisht pajtohem me theksin që ajo i ka vendosur qëllimit të dënimit penal në aspektin kushtetues, i cili, krahas ndëshkimit për veprën penale të kryer, duhet të realizojë edhe funksionin riedukues të të dënuarit për riintegrimin e tij në shoqëri (shih paragrafët 21–22 të vendimit). Në një shtet ku sundon ligji, organet kushtetuese, përfshirë Gjykatën, duhet të veprojnë sipas së drejtës në fuqi, duke ushtruar kompetencat që u janë dhënë me ligj, si dhe duke respektuar kompetencat e organeve të tjera. Sistemi ynë kushtetues, bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve, kompetencën e parashikimit të dënimeve penale me ligj ia ka dhënë Kuvendit, ndërsa caktimin e tyre, në raste konkrete, ua ka besuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë kuptim, Gjykata nuk mund të ushtrojë

funksionin e caktimit të dënimit penal, por mund dhe duhet të ndërhyjë vetëm në rastet kur këto pushtete të pavarura kanë vepruar arbitrarisht në tejkalim të kompetencave të tyre, duke cenuar parimet dhe të drejtat kushtetuese. Në rastin konkret, nuk është verifikuar një situatë e tillë, përkundrazi, Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave të saj, duke dhënë arsye të qarta ligjore dhe faktike se përse caktimi i dënimit penal nga gjykata e shkallës së parë ishte i drejtë në raport me atë të caktuar nga gjykata e apelit (shih paragrafët 21–23 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Rrjedhimisht, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, e cila në thelb, ka vlerësuar llojin dhe masën e dënimit penal, që duhej caktuar ndaj kërkuesit.

20. Për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësoj se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk duhej të pranohej nga Gjykata dhe se ajo duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

NJOFTIM

Nr. 9097, datë 25.5.2023

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshjet ndërkombëtare të hyra në fuqi më 3 maj 2023 janë si vijon:

1. Marrëveshja për lirinë e lëvizjes me kartë identiteti në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar në Berlin, më 3.11.2022;

2. Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve, në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, nënshkruar në Berlin, më 3.11.2022.

3. Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar në Berlin, më 3.11.2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Gazmend Turdiu

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë